

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7000
E mërkurë, 20 shtator 2023
Çmimi 0.40 €

Osmani takohet me Scholzin
në Nju-Jork: Partneriteti në mes
të Kosovës dhe Gjermanisë
është i palëkundur **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDOJNË REAGIMET PAS DËSHTIMIT TË TAKIMIT TË
14 SHTATORIT NË BRUKSEL **FAQE 4-5**

SHBA-ja DHE BE-ja DUAN HAP KONKRET NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI



- Bashkimi
Evropian pa
parakushte
kërkon
themelimin e
Asociacionit
të Komunave
me Shumicë
Serbe

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) i kanë dhënë mbështetje Bashkimit Evropian (BE), si ndërmjetësues i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, pavarësisht prej kritikave të kryeministrit Albin Kurti në adresë të emisarit Miroslav Lajçak. Nga

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) kanë thënë se presin nga Kosova dhe Serbia t'i përmbushin obligimet e dala nga dialogu. Ndërsa BE-ja të martën nëpërmjet një deklarate, pas takimit të Josep Borrellit me ministrat e jashtëm të bllokut evropian në Nju-Jork, ka

kërkuar nga Kosova ta fillojë punën për themelimin e Asociacionit pa vonesë dhe pa parakushte. BE-ja ka lënë të nënkuptohet se Kurti është duke e rrezikuar parimin e konfidentalitetit në dialog, edhe pse nuk e ka përmendur emrin e tij

**GRUDA: PËRMES
DEKRETIMIT TË LIGJIT
ANTIKUSHTETUES
PËR ZYRTARËT
PUBLIKË, OSMANI
DHE QEVERIA SHKELËN
PËR HERË TË DYTË
KUSHTETUTËN**



FAQE 7

**PARA KUVENDIT TË KOSOVËS
DUHET TË RAPORTOHET PËR
BISEDIME NË BRUKSEL**

REAGIM I
KMDLNJ-së



AKTUALE




**KRASNIQI: KËRKESA PËR
DORËHEQJEN E KRYETARËVE VJEN
NGA BEOGRADI, ZGJEDHJET NË
VERI VETËM ME PETICION **F. 5****

**OPOZITA KËRKON KUJDES GJATË
HARTIMIT TË LIGJEVE **F. 7****

**ARRESTOHEN DHJETË PERSONA TË
DYSHUAR PËR KRIME KIBERNETIKE **F. 6****

**MIRATOHET UDHËZUESI PËR
MBROJTJEN E PERSONAVE QË
RAPORTOJNË PËR INTERES PUBLIK **F. 7****

EKONOMI



**ATK-JA PËR TETË MUAJ SHQIPTOI
3.1 MILIONË EURO GJOBA NDAJ
BIZNESEVE **F. 8****

**SKËNDERI: QEVERIA NUK ËSHTË
DUKE PRODHUAR POLITIKA
EFIKASE EKONOMIKE **F. 8****

SPORT



**VËMENDJA NË PËRBALLJEN
BAYERN - UNITED **F. 10****

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: Mbi 1 200 fëmijë për pesë muaj humbën jetën në Sudan nga fruthi dhe kequshqyerja

KHARTOUM, 19 SHTATOR - Më shumë se 1 200 fëmijë nën moshën pesëvjeçare kanë vdekur nga fruthi dhe kequshqyerja në nëntë kampet e refugjatëve të Sudanit që nga maji, dhe dhjetëra mijëra të tjerë janë në rrezik deri në fund të vitit, ka bërë me dije Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). “Për shkak të sulmeve të vazhdueshme ndaj shërbimeve shëndetësore dhe sigurisë ushqimore që ka pësuar një goditje të madhe në Sudan, UNICEF ka frikë se

mijëra të porsalindur do të vdesin nga tani deri në fund të vitit”, është thënë në deklaratën e OKB-së. Sipas UNICEF-it, siguria ushqimore në vend, ku ka shpërthyer një konflikt i përgjakshëm mes gjeneralëve rivalë, ka marrë një “goditje katalitike”. Sipas ekipeve të UNHCR-së, më shumë se 1 200 fëmijë nën moshën pesëvjeçare kanë vdekur nga fruthi dhe kequshqyerja në nëntë kampet e refugjatësh të vendosura në

shtetin e Nilit të Bardhë midis 15 majit dhe 14 shtatorit. Këta fëmijë janë refugjatë nga Etiopia dhe Sudani i Jugut, ka thënë dr. Alain Maina, shef i shëndetit publik i komisionarit të lartë të OKB-së për refugjatët, në konferencën për medie. Sipas UNHCR-së, më shumë se 3 100 raste të dyshuara të fruthit u raportuan gjithashtu gjatë së njëjtës periudhë, dhe më shumë se 500 raste të dyshuara të kolerës në pjesë të tjera të vendit, si dhe raste të dengës dhe malaries.



Sekretari amerikan: Tanket ‘Abrams’, së shpejti në Ukrainë

BERLIN, 19 SHTATOR - Ukraina “shpejt” do të pranojë nga Shtetet e Bashkuara tanket “M1 Abrams”, përderisa forcat e Kievit kanë bërë përparim “të qëndrueshëm” në kundëroftensivën ndaj trupave të Moskës, ka thënë sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin. Në fillim të vitit Uashingtoni i ka premtuar Kievit këto lloje tankesh. Ato janë pjesë e ndihmës së sigurisë në vlerë mbi 43 miliardë dollarë që ShBA-ja i ka ndarë për Ukrainën që kur Rusia ka nisur pushtimin e paprovokuar të fqinjët të saj në shkurt të vitit 2022. “Me kënaqësi njoftoj se tanket ‘M1 Abrams’, që ShBA-ja më herët i ka premtuar (Kievit), shpejt do të hyjnë në Ukrainë”, ka thënë Austini në nisjen e takimit të Grupit të Kontaktit në Gjermani për Ukrainën. Tanket do të pajisen me municione 120 milimetërshe me uranium të varfëruar.



Municione të tilla, që ShBA-ja ka njoftuar muajin e kaluar se do t'i japë Ukrainës - janë kundërthënëse pasi lidhen me probleme shëndetësore, sikurse kanceri dhe defektet në lindje. Këto probleme shëndetësore janë raportuar në zonat ku municione me uranium të varfëruar janë përdorur në konflikte në të kaluarën edhe pse ende nuk është përcaktuar përfundimisht se ato i

kanë shkaktuar këto probleme. Ukraina ka nisur kundëroftensivën ndaj forcave ruse në qershor, por kundërsulmi ka qenë më i ngadalshëm, përderisa forcat e Kievit janë përballur me mbrojtje të ashpër. Austini ka thënë se kundëroftensiva “po vazhdon të bëjë përparim të qëndrueshëm”. “Trupat ukrainase po thejnë vijat e fortifikuara të ushtrisë agresore të Rusisë”, ka thënë ai. Po ashtu, shefi i mbrojtjes i ShBA-së ka mirëpritur ministrin e ri të Mbrojtjes të Ukrainës, Rustem Umerov, i cili është emëruar në këtë pozitë më herët gjatë këtij muaji. Një zyrtar i mbrojtjes në ShBA-së ka

thënë para takimit në Gjermani se ky takim është një mundësi “për të dëgjuar nga Umerovi për vizionin e tij dhe për prioritetet e tij”. ShBA-ja ka udhëhequr mbështetjen ndërkombëtare për Ukrainën, duke krijuar një koalicion që mbështet Kievin, pasi Rusia nisi pushtimin. Dhjetëra shtete marrin pjesë në Grupin e Kontaktit për Ukrainën. Mbështetësit e Ukrainës, po ashtu, u kanë ofruar trajnim trupave të Kievit, ndërsa ShBA-ja dhe shtetet e tjera kanë vendosur sanksione të ashpra ndaj Rusisë, që kanë prekur sektorin financiar, atë të teknologjisë dhe eksportet e energjisë.

Zelensky: Putini është ‘Hitleri i dytë’, Ukraina po lufton për ta parandaluar Luftën e Tretë Botërore

NJU-JORK, 19 SHTATOR - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, e ka fajësuar Rusinë për “ngritjen e një Hitleri të dytë” në formën e Vladimir Putinit. Duke folur për “CBS” në “60 Minutes”, presidenti ukrainas ka deklaruar se Ukraina po lufton për ta parandaluar Luftën e Tretë Botërore, shkruajnë mediet e huaja. “Ne nuk mund ta ndryshojmë Putinin. Shoqëria ruse ka humbur respektin e botës: ata e zgjedhën dhe e rizgjedhën dhe ngritën një Hitler të dytë. Ata e bënë këtë. Ne nuk mund të kthehemi pas në kohë, por ne mund ta ndalojmë këtë”, ka thënë Zelensky. Ndërkohë ai ka vënë në pikëpyetje pse Kombet e Bashkuara kanë lejuar ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, të marrë pjesë në organizmin botëror në mes të pushtimit të vazhdueshëm të Kremlinit ndaj kombit të tij. Ndërsa vizitonte një spital në Nju-



Jork, ku po trajtohen ushtarët ukrainas, Zelensky ka shtuar se trupi i liderëve botërorë duhet të përgjigjet për vendimin e tyre për ta lejuar Lavrovin të marrë pjesë. Ndryshe, më vonë sot ai do t'u drejtohet liderëve botërorë në Asambleen e Përgjithshme të OKB-së dhe do të flasë për luftën në Ukrainë nesër në një takim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Azerbajxhani nis operacion “kundër-terrorizmit” në Nagorno-Karabak

BAKU, 19 SHTATOR - Ministria e Mbrojtjes e Azerbajxhanit ka thënë se ka nisur operacione “kundër-terrorizmit” në rajonin e shkëputur të Nagorno-Karabakut, që është nën kontrollin e Armenisë. Tensionet kanë qenë të larta që disa muaj në këtë enklavë etnike armene, e cila njihet ndërkombëtarisht si pjesë e Azerbajxhanit.

Njëmbëdhjetë zyrtarë policorë të Azerbajxhanit dhe civilë është raportuar të jenë vrarë si pasojë e një shpërthimi me mina dhe një incidenti tjetër.

Sirenat ajrore është raportuar të jenë dëgjuar në qytetin kryesor të Karabakut. Zyrtarë të mbrojtjes armene në rajonin e shkëputur kanë thënë se ushtria e Azerbajxhanit e ka shkelur “armëpushimin në linjat e kontaktit përmes sulmeve me raketa”. Përfaqësues të tjerë të Karabakut kanë përmendur “ofensivë ushtarake të shkallës së gjerë”. Dy vendet fqinje, Azerbajxhani dhe Armenia, kanë luftuar dy herë për Nagorno-Karabakun, njëherë në fillim të viteve 1990, pas rënies së Bashkimit Sovjetik,

më pas më 2020. Prej dhjetorit Azerbajxhani e ka ndërtuar një bllokadë de-facto në rrugën e vetme që çon në Armeni, e njohur si Korridori Laçin. Të martën Ministria e Mbrojtjes në Baku i ka akuzuar forcat armene për “bombardime sistematike” të pozicioneve ushtarake dhe ka thënë se është përgjigjur duke nisur “aktivitete lokale kundër-terrorizmit... për t'i çarmatosur forcat e armatosura armene nga territoret tona”. Ministria ka insistuar se nuk është duke shënjestruar civilë, por qendra



ushtarake, me armë me precizitet të lartë. Ministria e Mbrojtjes në Armeni ka thënë

se pretendimet për sulme armene nuk përputhen me realitetin.

Propozim ekspertësh franko-gjermanë për reformën e BE-së para zgjerimit

BRUKSEL, 19 SHTATOR - Para se të zgjerohet në më shumë se 30 vende anëtare, Bashkimi Evropian (BE) duhet të bëjë disa reforma në mënyrë që të jetë funksional. Zgjerimi i BE-së, në njërin anë, dhe thellimi i integriteteve brenda unionit, duhet të shkojnë paralelisht. Këto janë porositë kryesore të një raportit franko-gjerman për reformat e BE-së para se ajo të zgjerohet.

Raporti, tekstin e të cilit e ka siguruar "Radio Evropa e Lirë", i porositur nga qeveritë e këtyre dy vendeve kryesore të BE-së, është përpiluar nga 12 ekspertë të pavarur dhe nuk paraqet qëndrimet zyrtare të këtyre dy shteteve. Por, ky raport do të shërbejë për debatin që pritet të zhvillohet ndërmjet vendeve anëtare të BE-së dhe institucioneve të bllokut për reformat e nevojshme.

Sa i përket zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE), në raport propozohet që vendimet për t'i hapur apo mbyllur kapitujt në procesin negociator, të miratohen në të ardhmen me shumicën e kualifikuar në Këshill e jo siç është tash me unanimitet. Në këtë mënyrë, vlerëson raportin, do të përshpejtohej procesi.

Mirëpo, në fund, vendimi për pranimin e një shteti të ri anëtar do të mbetet vendim që duhet të miratohet me unanimitet nga të gjitha vendet ekzistuese anëtare. Në këtë raport mbështetet ideja që BE-ja dhe vendet anëtare të bëhen gati për zgjerim deri në vitin 2030, ide që para disa javësh e kishte përmendur edhe presidenti i

Këshillit Evropian, Charles Michell. Vendet candidate do të duhej deri atëherë të punojnë për t'i përmbushur kriteret e nevojshme.

Raporti në fjalë propozon që lidhshipin e ri i BE-së, i cili do të dalë nga zgjedhjet evropiane të qershorit të vitit 2024, do të duhej të obligohej për ta bërë vitin 2030 si afat për zgjerim dhe BE-ja të jetë e gatshme për këtë deri në këtë afat.

Propozohet që deri më 2030 BE-ja dhe shtetet candidate të jenë gati për zgjerim.

Po ashtu, propozohet që raundet e zgjerimit të ndahen në grupe të shteteve (një lloj regate). Për t'u bërë gati, sipas këtij raportit, BE-ja do të duhet të vendosë nëntë parime, sipas së cilave, do të drejtohej strategjia e ardhshme e zgjerimit. Këto parime do të ndaheshin në dy pika.

Pika e parë do të ishte "kualifikimi për anëtarësim në BE", që ka të bëjë me përgatitjen e vendeve anëtare, pika e dytë "dinamika e procedurave të anëtarësimit", që nënkupton përgatitjen e institucioneve të BE-së.

Në kualifikimin për anëtarësim, që ka të bëjë me përmbushjen e kushteve nga vendet candidate, ky propozim përmend pesë pika kyçe: Çështjet fundamentale së pari, aspektet gjeopolitike, zgjidhja e konflikteve, mbështetja shtesë teknike dhe financiare dhe legjitimiteti demokratik. Këto propozime shkojnë, po ashtu, në përputhje me thirrjet që vendet, të cilat duan të hyjnë në BE më parë, duhet t'i zgjidhin konfliktet me



fqinjët, në mënyrë që në BE të mos barten probleme bilaterale. Në çështjet që kanë të bëjnë me dinamikën e anëtarësimit, propozimi përmend pikat kyçe: barazinë, sistematizimin, reverbilitetin (mundësi kthimi) dhe votimin me shumicë të kualifikuar.

Disa parime që ka në këtë moment BE-ja si, për shembull, votimin me unanimitet dhe parimin që secili shtet të ketë një anëtar të Komisionit Evropian, nuk do të mund të mbaheshin në të ardhmen dhe, sipas këtij raportit, do të duhej ndryshuar.

Raporti ka theksuar se në një BE më të zgjeruar do të duhej të kishte më pak anëtarë të Kolegjit të Komisionit Evropian sesa që ka vende anëtare. Do të duhej, si alternativë, që të ketë dy lloj komisionarësh, një "komisionar udhëheqës" dhe një komisionar të thjeshtë. Vetëm "komisionarët udhëheqës" do të kishin të drejtë të votonin në Komisionin Evropian.

Zvogëlimi i Komisionit Evropian

në më pak anëtarë sesa që BE-ja ka vende anëtare ka qenë synim edhe nga e kaluara. Por, kjo nuk ka mundur të ndodhë pasi shumë vende anëtare e kanë kundërshtuar. Sidomos vendet më të vogla të BE-së kanë insistuar që secili shtet të ketë një anëtar të Komisionit Evropian, duke thënë se në këtë mënyrë sigurohet barazia e tyre, pa marrë parasysh madhësinë.

Parlamenti Evropian do ta mbante numrin maksimal të anëtarëve në të ardhmen në 751, pa marrë parasysh se me sa shtete do të zgjerohet BE-ja.

Gjithashtu, propozohen ndryshime edhe në miratimin e buxhetit të përbashkët të Bashkimit Evropian, në atë mënyrë që BE-ja ta mbushë buxhetin edhe me resurse të veta, pa kërkuar nga vendet anëtare përmes taksave të ndryshme. Ndërsa korniza shumëvjeçare financiare do të miratohet çdo pesë vjet, sa edhe zgjat mandati i Parlamentit Evropian dhe Komisionit Evropian e jo siç është

tash çdo shtatë vjet.

Ajo që ndoshta do të shkaktojë më së shumti kundërshtime në debate është propozimi që "integritet evropiane" të kenë "katër shpejtësi". Propozohet që vendet të cilat duan ta thellojnë integritetin mes tyre të mund ta bëjnë këtë pa pasur nevojë të presin që me një gjë të tillë të pajtohen të gjithë në BE.

Sipas propozimit, brenda BE-së do të ketë një "rreth të brendshëm" të vendeve që do të thellonin integritetin mes tyre. Pas këtij rrethi do të vinte e tërë BE-ja, pra të gjitha vendet anëtare.

Niveli i tretë i integriteteve do të ishte "vendet e asociuara", ndërsa niveli i katërt i integriteteve do të ishte Bashkësia Politike Evropiane (EPC) që tashmë ka nisur takimet sipas propozimit të presidentit të Francës, Emanuel Macron. Në këtë bashkësi janë të gjitha vendet e kontinentit të Evropës që duan t'i ndajnë interesat e përbashkëta.

Thirrjet për reforma në BE, si kusht për t'u zgjeruar, janë përsëritur shumë gjatë muajt e fundit. Por, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se, nëse kërkohej ndryshime në Traktatin e BE-së, atëherë zgjerimi i bllokut nuk duhet të presë derisa të bëhen ndryshimet, por të bëhet më shpejt. Në anën tjetër, janë vendet si Franca që insistojnë se BE-ja me kornizën e tashme ligjore dhe procedurën e miratimit të vendimeve që ka në fuqi, nuk do të mund të funksiononte si duhet nëse zgjerohet tutje pa u reformuar nga brenda.

Osmani takohet me Scholzin në Nju-Jork: Partneriteti në mes të Kosovës dhe Gjermanisë është i palëkundur

NJU-JORK, 19 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, është duke e vazhduar qëndrimin në Nju-Jork, aty ku po mbahet sesioni i 78 i Asamblesë së Kombeve të Bashkuara. Në kuadër të këtij qëndrimi Osmani është takuar të martën me kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz.

Takimi në Nju-Jork ka ndodhur në pritjen e organizuar nga Scholzi për nder të 50-vjetorit të anëtarësimit të Gjermanisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Me këtë rast, Osmani është shprehur se partneriteti në mes të Kosovës dhe Gjermanisë është i palëkundur. "E urova kancelarin Scholz për angazhimin gjysmëshekullor të Gjermanisë për paqe, zhvillim dhe bashkëpunim kudo në botë. Jemi krenarë për partneritetin e palëkundur në mes dy vendeve tona, të cilin do të vazhdojmë ta forcojmë tutje!", ka thënë Osmani.



Po ashtu, Osmani në Nju-Jork është takuar edhe me këshilltarin në Departamentin Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, dhe të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Në takim me zyrtarët e lartë amerikanë, presidentja Osmani ka zhvilluar diskutime përmbajtjesore lidhur me

zhvillimet e fundit në procesin e dialogut me Serbinë. "Suksesi i dialogut varet nga qasja parimore dhe e barabartë për zbatimin e plotë të marrëveshjes, por edhe nga angazhimi dhe roli prijës i ShBA-së, e cila është çelësi për përmbylljen e suksesshme të dialogut dhe që do të çonte në një njohje të ndërsjellë", ka theksuar



Osmani. Më tutje, Osmani ka shprehur mirënjohjen e saj për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së, duke theksuar se Kosova është e interesuar të ecë përpara në rrugëtimin euroatlantik, me mbështetje dhe koordinim me aleatët. Presidentja e Kosovës, Vjosa

Osmani, ka takuar në Nju-Jork edhe ish-presidentin e ShBA-së, Bill Clinton dhe ish-komandantin e NATO-s, Wesley Clark. Osmani i ka quajtur heronj Clintonin dhe Clarkun. Osmani gjatë qëndrimit në Nju-Jork është takuar edhe me përfaqësues të shteteve të ndryshme.



VAZHDOJNË REAGIMET PAS DËSHTIMIT TË TAKIMIT TË 14 SHTATORIT NË BRUKSEL

ShBA-ja dhe BE-ja duan hap konkret në dialogun Kosovë - Serbi

- Bashkimi Evropian pa parakushte kërkon themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) i kanë dhënë mbështetje Bashkimit Evropian (BE), si ndërmjetësues i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, pavarësisht prej kritikave të kryeministrit Albin Kurti në adresë të emisarit Miroslav Lajçak. Nga Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) kanë thënë se presin nga Kosova dhe Serbia t'i përmbushin obligimet e dala nga dialogu. Ndërsa BE-ja të martën nëpërmjet një deklarate, pas takimit të Josep Borrellit me ministrat e jashtëm të bllokut evropian në Nju-Jork, ka kërkuar nga Kosova ta fillojë punën për themelimin e Asociacionit pa vonesë dhe pa parakushte. BE-ja ka lënë të nënkuptohet se Kurti është duke e rrezikuar parimin e konfidencialitetit në dialog, edhe pse nuk e ka përmendur emrin e tij

EPOKA
ERE

Lirim GEÇI

PRISHINË, 19 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka akuzuar ashpër emisarin e Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Ai në takimin e 14 shtatorit në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vučić, e ka akuzuar Lajçakun se është "pozicionuar" kundër Kosovës. Pa kaluar 24 orë nga akuzat e Kurtit ndaj Lajçakut kanë reaguar nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Bashkimi Evropian (BE) të martën ka qenë i qartë në raport me obligimet që kanë Kosova dhe Serbia në procesin e dialogut. BE-ja ka kërkuar që puna për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe të nisë "pa vonesë të reja dhe parakushte". Kështu është thënë në deklaratën e lëshuar nga

shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, pas takimit me ministrat e Jashtëm të bllokut në Nju-Jork, në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Ai i ka informuar kryediplomatët evropianë për raundin e fundit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Për Asociacionin, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje më 2013. Por, Kosova nuk e ka zbatuar atë, duke shprehur frikën se mund ta cenojë funksionalitetin e shtetit. "BE-ja u kërkon palëve të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe me mirëbesim. Kjo nënkupton fillimin e zbatimit bazuar në propozimin e BE-së pa vonesë të mëtejshme, i cili, gjithashtu, përfshin detyrimin e të dyja palëve për t'i zbatuar plotësisht të gjitha marrëveshjet e dialogut të kaluar. Puna për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe duhet

të fillojë pa ndonjë vonesë apo parakusht të mëtejshëm", është thënë në deklaratën e BE-së.

BE-ja ka lënë të nënkuptohet se Kurti është duke e rrezikuar parimin e konfidencialitetit në dialog, edhe pse pa përmendur emrin. Sipas BE-së, është shqetësues fakti që situata në veri është ende e tensionuar. "BE-ja ua kujton palëve përgjegjësinë e tyre për ta respektuar parimin e konfidencialitetit në dialog, i cili është një komponent kyç i çdo procesi negociator të ndjeshëm politik. BE-ja mbetet po aq e shqetësuar për mungesën e progresit nga të dyja palët për shpërshkallëzimin e tensioneve në veri të Kosovës, disa muaj pas shpërthimit të fundit të dhunës që la të plagosur qytetarët, trupat e KFOR-it, forcat e rendit dhe përfaqësuesit e medieve, disa me pasojë të rënda dhe të përhershme", është thënë në deklaratën e BE-së,

duke shtuar se është e shqetësuar me mungesën e përparimit nga të dyja palët për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës, disa muaj pas rritjes së tensioneve "Në këtë kontekst, lëvizjet e Kosovës – duke përfshirë shpronësimet e tokës në veri të Kosovës, urdhrat e dëbimit, telekomunikacionin dhe përdorimin e forcave speciale të policisë për detyrat e policisë në komunitet – nuk janë në përputhje me sundimin e ligjit dhe rrezikojnë të kontribuojnë për rritjen e mëtejshme të tensioneve. Sulmet e vazhdueshme në shkallë të vogël nga grupet kriminale dhe frikësimi i kadetëve të policisë serbe të Kosovës të saporekrutuar/popullatës lokale janë të papranueshme dhe duhet të ndalen menjëherë. Bllokimi i udhërrëfyesit nga ana e Serbisë, si dhe përpjekjet e tjera që nuk janë në përputhje me marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit dhe aneksin e saj, bien ndesh me frymën e procesit të dialogut", është thënë në deklaratën e BE-së. Deklarata e BE-së ka marrë mbështetje nga Gjermania dhe Britania e Madhe.

Zyrtari i lartë amerikan kërkon angazhim urgjent në dialogun Kosovë - Serbi

Pas akuzave dhe ashpërsisë së Kurtit ndaj Lajçakut kanë ardhur edhe reagime nga ShBA-ja. Megjithatë, me një mesazh të qartë e të ashpër ishte

edhe përgjigja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për deklaratat e Kurtit. Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) i ka dhënë përkrahje emisarit Lajçak.

Në një përgjigje për "Zërin e Amerikës", zëdhënësi i DASH-it nuk e ka konfirmuar ose mohuar marrjen e një letre që Kurti ka thënë se ua kishte dërguar vendeve perëndimore, por ka theksuar se ShBA-ja mbetet e përkushtuar për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga BE-ja. "Ne (ShBA) mbetemi të angazhuar ngushtë me Kosovën, Serbinë dhe partnerët e BE-së në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Falënderojmë dhe njohim përpjekjet e palodhura të përfaqësuesit të posaçëm të BE-së, Miroslav Lajçak", ka thënë zëdhënësi i DASH-it.

Ai ka theksuar se ShBA-ja mbetet e zhgënjyer për mungesën e përparimit në takimin e fundit më 14 shtator, duke theksuar se dialogu i BE-së është rruga e vetme përpara për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Po ashtu, ai ka theksuar rëndësinë e respektimit të detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje për arritjen e progresit në dialog, duke përfshirë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Ne presim që të dy vendet t'i marrin seriozisht detyrimet e tyre sipas marrëveshjes mbi rrugën drejt normalizimit që arritën në fillim të këtij viti. Koha po mbaron. Ne

Para Kuvendit të Kosovës duhet të raportohet për bisedime në Bruksel

Reagim i KMDLNj-së

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër dje, në një konferencë para mediave foli për ecurinë përkatësisht për dështimin e takimit në Bruksel pas së cilit faktorët vendimmarrës e fajësuan Kosovën në ndërkohë që për Serbinë deklaruan se: "ishte përgatitur mirë dhe kreu detyrat e shtëpisë, gjithashtu mirë..."

Pas këtyre reagimeve aspak të mira për Kosovën, kryeministri Kurti tërë përgjegjësinë e adresoi të Lajçaku, i emëruar nga BE-ja për lehtësim të bisedimeve me arsytim se Lajçaku bashkë me Vuçiqin kanë komplotuar kundër Kosovës dhe, për më keq, Lajçaku qëndrimet e Vuçiqit i ka paraqitur si qëndrime të tija që rëndë e kompromiton rolin e tij si ndërmjetësues i paanshëm nëse pohimet e kryeministrit Kurti

dalin të sakta.

Pas kësaj, BE-ja dhe Departamenti i Shtetit Amerikan dolën në përkrahje të plotë të Lajçakut në ndërkohë që në Kosovë iu nënshtrua një pushkatimi publik, urbi et orbi. KMDLNj edhe më herët ka shprehur rezerva ndaj Lajçakut dhe Borrellit mirëpo këta janë përfaqësues të BE -së dhe Kosova mund të caktojë përfaqësuesit e saj në këto bisedime por jo edhe të BE -së.

Pas këtyre, jo dyshimeve por akuzave publike të Kurtit ndaj Lajçakut, duhet të merret një qëndrim: a do të vazhdojë kryeministri Kurti të takohet me Vuçiqin me ndërmjetësim të Lajçakut dhe Borrellit? Pikërisht kjo do të duhet të ishte arsye e domosdoshme që kryeministri Kurti të thërras një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës dhe përmes adresimit të kësaj situatë që, nëse është e vërtetë krijon një momentum të ri në bisedime e që për Kosovën do



të ishte i papranueshëm.

Kryeministri Kurti do të duhet të kërkonte përkrahjen e Kuvendit, pozitë dhe opozitë duke ndërtuar një qëndrim të përbashkët në të cilin nuk do të formohet Asociacioni i Komunave serbe në Kosovë pa njohje reciproke nga Serbia dhe garancion ndërkombëtar për këtë. Në vend se kryeministri Kurti ta kapë problemin nga koka (situata e re në bisedime me Serbinë ku përkrahja e opozitës është e

domosdoshme) ai merret me zhdukjen e opozitës, slogan purpolitik dhe elektoral. Në këto çaste bisedimet me Serbinë janë prioritet absolut ndërsa zgjedhjet dhe zhdukja janë të krejtësisht të parëndësishme në këtë kohë.

Po në atë adresim para gazetarëve, zëvendëskryeministri Bislimi, me një patriotizëm patetik kërcënoi "mediat e financuara nga Beogradi" se ia paskan shtrembëruar intervistën që ia ka dhënë gazetës serbe "Danas" ku qartazi thuhej se Kosova ka bërë gabim që në Marrëveshjen e Brukselit paska hequr dorë nga njohja nga Serbia. Është interesant pse Bislimi nuk ka reaguar menjëherë pasi intervista u bë publike, por këtë e bëri vetëm pas një jave pikërisht pas dështimit të takimit në Bruksel! Nuk është hera e parë që Bislimi sulmon mediat në kryerjen e mandatit dhe misionit që e kanë duke i ndarë në media të Serbisë dhe të tjera. Është lehtë të

verifikohet e vërteta e Besnik Bislimit apo nëse citimi nga mediat kosovare të Serbisë (sipas Bislimit) janë qëllimkëqija dhe tendencioze. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) është kundër kësaj qasjeje të papërgjegjshme të zëvendëskryeministrit Bislimi ndaj mediave dhe atyre që nuk e ndajnë qëndrimin e njëjtë me të. Besnik Bislimi duhet të jetë njeriu i fundit në Kosovë që e bënë diferencimin e mediave dhe të tjerëve në patriotë dhe tradhtarë aq më parë që është shumë jotransparent në procesin që po e udhëheq e që po pëson goditje të vazhdueshme, të dëmshme për Kosovën.

Bartja e posteve me përgjegjësi kërkon përgjegjësi të lartë dhe përjashtim të çdo arrogancë dhe shpërfillje. Duhet një hetim parlamentar për këtë çështje sepse përveç se është shkelje e të drejtave të njeriut, paraqet rrezik edhe për sigurinë e vendit.

duam të shohim përparim në detyrimet ekzistuese dhe të mëparshme bazuar te dialogu (i lehtësuar nga BE-ja) dhe marrëveshja e Ohrit, përfshirë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe", ka thënë zëdhënësi i DASH-it.

Në fund, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit citohet të ketë thënë se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara të bashkëpunojnë me partnerët evropianë dhe të konsultohen për hapat e ardhshëm në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Sikur të mos mjaftonte kjo deklaratë e zëdhënësit të DASH-it, Miroslav Lajçak ka shkruar në "X" për një darkë me Derek Chollet dhe Gabriel Escobar. Ai ka thënë se kanë qëndrime të njëjta për situatën në Ballkanin Perëndimor: "Kishim darkë mes miqsh të mirë në Nju-Jork me Derek Chollet dhe Gabriel Escobar. Gjithmonë është e dobishme të rikonfirmojmë se shprehim të njëjtin lexim të situatës në Ballkanin Perëndimor dhe jemi në të njëjtën linjë në lidhje me rrugën përpara", ka shkruar Lajçaku.

Pas këtij takimi, këshilltari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit,

Derek Chollet, ka biseduar me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, për angazhimin në dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe për "nevojën për ta shtensionuar situatën" në veri të Kosovës.

Chollet, së bashku me të dërguarin e Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, kanë takuar Osmanin në Nju-Jork. "Një bisedë e mirë me presidenten Vjosa Osmani për zotimin tonë të përbashkët për të ardhmen euroatlantike të Kosovës, për nevojën për ta shtensionuar situatën dhe për angazhimin urgjent në dialogun për normalizimin e raporteve me Serbinë që lehtësohet nga BE-ja - që është kyç për stabilitetin rajonal dhe integrimin drejt BE-së", ka shkruar Chollet në "X".

Kujtojmë se pas takimit më 14 shtator, nga BE-ja kanë thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk ka qenë i gatshëm të ecë përpara, ndryshe nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili "e ka pranuar propozimin e tyre" për zbatimin e Marrëveshjes Bazë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi.



Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Jozep Borrell, i cili bashkë me të dërguarin e BE-së për dialog, Miroslav Lajçak, kanë ndërmjetësuar takimin, ka thënë se Kurti ka këmbëngulur të formalizohet fillimisht njohja de facto e Kosovës nga Serbia.

Më 18 shtator kryeministri Kurti e ka akuzuar për "njëanshmëri" Lajçakun, i cili, sipas tij, "u pozicionua" kundër Kosovës. Kurti ka thënë se ai në Bruksel ka paraqitur një plan për zbatimin e sekuencuar të Marrëveshjes Bazë dhe Aneksit të saj, për të cilat Kosova dhe Serbia u pajtuan më herët gjatë këtij viti. Por, ky plan, sipas tij, është refuzuar nga Serbia dhe BE-ja. Kjo

marrëveshje nuk përfshin njohjen reciproke për të cilën insiston Kosova, por kërkon nga Kosova dhe Serbia t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njër-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat. Po ashtu, palët zotohen se do t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura më herët në procesin e dialogut.

BE-ja për deklaratat e Kurtit: Nuk i komentojmë akuzat e pabaza

Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, i ka cilësuar "akuza të pabaza" pohimet e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, duke theksuar se ky i fundit ka mbështetur e të gjitha shteteve anëtare të bllokut.

Stano është pyetur nga gazetarët se si mund të vazhdojë dialogu në këtë format pasi Kurti hapur ka shprehur mosbesim ndaj lehtësuesit të procesit, të cilin nuk e ka konsideruar neutral dhe të

paanshëm. "Sa iu përket deklaratave të Kurtit, ne nuk i komentojmë ato, sidomos kur përmbajnë akuza të pabaza. Mendoj se shtetet anëtare të BE-së në vazhdimësi e kanë përsëritur shumë qartë mbështetjen e tyre të plotë për përfaqësuesin e posaçëm të BE-së, Miroslav Lajçak, sikur edhe për përfaqësuesin e lartë (Josep Borrell). Ata plotësisht mbështetnin përpjekjet e tyre që Kosovës dhe Serbisë t'u ndihmohet të arrijnë në fazën kur t'i normalizojnë raportet", ka thënë ai. Sipas Stanos, mbështetja e fundit për lehtësuesit e dialogut, Borrell dhe Lajçak, ka ardhur përmes komunikatës së lëshuar në emër të 27 shteteve të bllokut më 19 shtator. "Kjo do të thotë se është një deklaratë e miratuar nga ministrat e jashtëm të 27 shteteve anëtare. Dhe kjo deklaratë saktësisht nënvizon pritjet e BE-së për Kosovën dhe Serbinë dhe si të ecet përpara në dialog", ka thënë Stano, duke theksuar se në deklaratë në mënyrë "eksplicite kërkohej nga Kosova dhe Serbia të ecin me zbatimin e obligimeve të tyre pa vonesa të reja".

Krasniqi: Kërkesa për dorëheqjen e kryetarëve vjen nga Beogradi, zgjedhjet në veri vetëm me peticion

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se kërkesa për dorëheqjen e kryetarëve të komunave veriore vjen nga Beogradi. Sipas tij, institucionet e Kosovës nuk duhet të brengosen për kërkesat që vijnë nga Serbia dhe se dorëheqja e katër kryetarëve është akt moral.

Ai ka thënë se për të mundësuar zgjedhje të parakohshme në atë pjesë ata veçse kanë marrë masat duke hartuar edhe udhëzimin

administrativ. Në këtë kontekst, Krasniqi ka thënë se zgjedhjet në veri do të mbahen vetëm me peticion. "Kosova është palë konstruktive në këtë proces. Ne tashmë kemi larguar dy herë nga 25 për qind të policisë nga objektet e komunave dhe e kemi udhëzimin administrativ që i hap rrugë peticionit të qytetarëve për largimin e kryetarëve. Këto janë veprime të vullnetit të mirë të qeverisë. Nuk ka asnjë autoritet që mund ta kërkojë

dorëheqjen. Ai është akt moral. Unë kam vazhdueshëm takim me kryetarët e komunave. Ata e kanë mbështetur procesin e peticionit. Mendoj se kjo është demokracia dhe ne duhet të përkujdesemi për demokracinë e jo për dëshirat e kujtdo qoftë. Dorëheqja e kryetarëve është kërkesë e Beogradit. Ne nuk jemi këtu që të brengosemi se çka mendon e çka kërkon Beogradi. Jemi këtu për demokracinë", ka thënë Krasniqi.



Komuna e Drenasit fton qytetarët të aplikojnë për legalizimin e ndërtimeve pa leje



DRENAS, 19 SHTATOR - Komuna e Drenasit ka njoftuar për zgjatjen e afatit për dorëzimin e aplikimeve për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Kjo komunë ka bërë me dije se qytetarët mund të aplikojnë për legalizimin e ndërtimeve pa leje nga 1 shtatori deri më 31 dhjetor të këtij viti. "Ju njoftojmë se Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Trajtimin e Ndretimeve pa Leje tashmë ka

hyrë në fuqi dhe nga data 1 shtator 2023 është hapur afati për dorëzimin e aplikimeve për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Qytetarët mund të drejtohen në komunën tonë dhe t'i dorëzojnë aplikimet për legalizim. Është shumë e rëndësishme për ju legalizimi i shtëpisë/ndërtimit tuaj, prandaj Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe drejtoritë e tjera të linjës mbesin të

përkushtuara për ofrimin e shërbimeve që ju ndihmojnë në legalizimin e ndërtimit tuaj. Kjo është edhe një mundësi e re për të gjithë ju që deri sot nuk keni mundur apo nuk keni pasur mundësinë të aplikoni për legalizim, që tash e tutje ta plotësoni dokumentacionin dhe të bëheni pjesë e legalizimit të objektit tuaj. Legalizo ndërtimin, mos e humb mundësinë!", ka njoftuar komuna e Drenasit.

Arrestohen dhjetë persona të dyshuar për krime kibernetike


PRISHTINË, 19 SHTATOR - Dhjetë persona janë arrestuar nga policia në aksionin që është kryer të hënën në katërmbëdhjetë lokacione të ndryshme në Kosovë. Të arrestuarit dyshohen për krime kibernetike që u janë shkaktuar bankave. "Të dyshuarit, në bashkëveprim me njëri-tjetrin, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, kanë përdorur kartelat bankare pa autorizim duke bërë transaksione, tërheqje të parave nga bankomatët dhe blerje të gjësendeve të ndryshme, me kartela bankare të cilat kanë arritur në forma të ndryshme t'i komprometojnë. Në këtë rast janë dëmtuar institucionet financiare (bankat) në Kosovë mijëra euro", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Mbi ta rëndojnë akuzat "lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit" dhe "hyrje në sistemet kompjuterike". Kontrollat janë realizuar në 14 lokacione në: Prishtinë, Gjiçan, Ferizaj, Kaçanik, Drenas, Suharekë dhe Deçan. Policia ka sekuestruar prova të ndryshme relevante, përfshirë kompjuterë, telefona celularë, USB, kartela bankare, dokumente si dhe tri armë dhe municion. Ndërsa hetuesit policorë para këtij arrestimi kanë zhvilluar veprime hetimore për një periudhë disamujore. Ndërsa Prokuroria e Themelore e Prishtinës ka njoftuar se 10 të arrestuarit në aksionin e së martës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Kibernetike të

Policisë së Kosovës, janë ndaluar për 48 orë. Sipas prokurorisë, ata dyshohet se kanë kryer veprat penale "Hyryra në sistemet kompjuterike", nga neni 327 dhe "Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit". Të dyshuarit, sipas prokurorisë, nga veprimet e tyre kanë dëmtuar katër institucione financiare në vlerë dyzet mijë euro. "Me vendim të prokurorit të shtetit janë ndaluar dhjetë (10) persona të dyshuar në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak të dyshimit të bazuar të veprave penale të lartcekura, e në të cilin rast aktualisht janë të dëmtuar katër (4) institucione financiare dhe vlera e dëmit e shkaktuar deri më tani tejkalon shumën prej 40 mijë eurosh", ka njoftuar prokuroria.



Policia interviston edukatoren që dyshohet se ushtruan dhunë ndaj një trevjeçari



PRISHTINË, 19 SHTATOR - Policia e Kosovës ka intervistuar tri edukatore të një çerdheje shtetërore në Fushë-Kosovë, nën dyshimet për ushtrim të dhunës ndaj një djali trevjeçar. Dëshmi në polici ka dhënë edhe prindi i fëmijës. Një ditë më herët familjarë të trevjeçarit kanë publikuar në rrjetet sociale incizime nga kamerat e sigurisë në çerdhen "Gëzimi Ynë" në Fushë-Kosovë, ku kanë thënë se shfaqen edukatoren duke ushtruar dhunë ndaj fëmijës. Drejtori i Arsimit në Fushë-Kosovë, Fatlum Berisha, ka thënë për mediet se edukatoren që

dyshohet të jenë përfshirë në këtë rast do të pezullohen nga puna pasi ta përfundojnë intervistimin në polici. Koalicioni i organizatave joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) ka reaguar pas kësaj ngjarjeje. "Nisur nga kjo ngjarje e rëndë, KOMF bën thirrje që institucionet përgjegjëse në përbushje të mandatit të tyre të ndërmarrin menjëherë veprimet dhe masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi", ka thënë ky koalicion. KOMF-i u ka bërë thirrje institucioneve ta rritin mbikëqyrjen dhe inspektimin e institucioneve parashkollore në

Kosovë "në mënyrë që të parandalohen rastet e tilla". Ky koalicion rikujtoi se sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe legjislacioneve të tjera, është ndaluar çdo formë e dhunës ndaj fëmijëve, përfshirë fizike, psikologjike dhe neglizhimin e fëmijëve. Sipas familjarëve që kanë publikuar pamjet, trevjeçari është rrahur nga dy edukatore, duke pretenduar se në dhunës ndaj fëmijës edhe pastruesja dhe kuzhinierja e këtij institucioni. Ata thanë, po ashtu, se fëmija po përjeton "trauma të rënda psikike, nuk mund të flejë më dhe po përjeton ankth të madh".

QKMF-ja në Podujevë furnizohet me katër automjete

PODUJEVË, 19 SHTATOR - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Podujevë është furnizuar me katër automjete. Kryetari i kësaj komune, Shpejtim Bulliqi, ka thënë se këto automjete janë blerë me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për pacientët, por edhe për ta lehtësuar punën e personelit

mjekësor. Bulliqi ka njoftuar se këto automjete janë blerë nga buxheti komunal. "Është bërë furnizimi me automjete për nevojat të shërbimeve të QKMF-së me katër automjete: një autoambulancë emergjente, një automjet për bartje të dializës, një autoambulancë e vogël për nevojat të vizitave të

shërbimit paliativ dhe një automjet për nevojat të vaksinimit dhe punëve teknike. Blerja e automjeteve po bëhet me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për pacientët, por edhe për ta lehtësuar punën e personelit mjekësor. Këto automjete janë blerë nga buxheti komunal", ka shkruar Bulliqi në "Facebook".



Opozita kërkon kujdes gjatë hartimit të ligjeve

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka mbajtur mbledhjen e parë në sesionin vjeshtor. Anëtarët e partive opozitare në këtë komision kanë bërë thirrje të rishikohen më shumë kujdes ligjet të cilat kalojnë nëpër këtë komisioni pasi, sipas tyre, një numër i ligjeve që po dërgohen në Gjykatën Kushtetuese janë duke u rrëzuar prej saj. Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se duke marrë parasysh që ky është një komision i rëndësishëm, duhet

të kihet më shumë kujdes ndaj ligjeve që bien ndesh me Kushtetutën.

Po ashtu, ai ka propozuar të formohet një grup i cili do ta bëjë plotësimin e ligjeve të cilat kanë kaluar në Kuvend. "Duhet të jemi të kujdesshëm maksimalisht, që ligjet që bien ndesh me Kushtetutën, t'i kemi parasysh dhe si Komision ta ngrehim në nivelin sa më lart. Nuk bën të jemi komision funksional e t'i trajtojmë ligjet me neglizhencë", ka thënë Tahiri.

Ndërsa deputetja e PDK-së, Blerta Deliu, ka thënë se si parti pajtohen që duhet që të respektohet Kushtetuta e vendit

dhe që të jenë më të kujdesshëm me ligjet të cilat kalojnë në këtë komision. "Në emër të PDK-së i bashkohem thirrjes së kolegëve të mi opozitarë për respektim të Kushtetutës, përderisa një pjesë e madhe e ligjeve që kanë përfunduar në Kushtetuese kanë marrë epilog kundërkushtetues. Normalisht që neve na bie barra dhe përgjegjësia si komision kryesor për të parë nëse do të kemi sërish përballje me ligjet të cilat e shkelin Kushtetutën", ka thënë ajo.

Ndërsa deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha, ka thënë se Ligji për Këshillin Prokurorial është trajtuar edhe në Komisionin e Venecias dhe se



janë marrë parasysh rekomandimet që janë dhënë. "Nëse Komisioni i Venecias ka dhënë rekomandime e ato rekomandime janë zbatuar,

atëherë nuk po mendoj që duhet filtër tjetër përveç që Gjykata Kushtetuese mendon ose di më mirë se Komisioni i Venecias", ka thënë Basha.

Gruda: Përmes dekretimit të Ligjit antikushtetues për Zyrtarët Publikë, Osmani dhe qeveria shkelën për herë të dytë Kushtetutën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Koordinator i Departamentit për Drejtësi në Kabinetin për Qeverisje të Mirë në PDK, Përparim Gruda, ka reaguar pas dekretimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë nga presidentja Vjosa Osmani, ndonëse Gjykata Kushtetuese e ka rrëzuar këtë ligj muajin e kaluar.

Gruda në një konferencë për medie ka thënë se ky është një akt i paprecedentë i mashtrimit publik dhe shkelje e qëllimshme e Kushtetutës, sepse vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë obligative për të gjitha autoritetet publike në Kosovë. "Me këtë akt, fatkeqësisht, edhe presidentja e Kosovës, e cila e ka dekretuar këtë ligj, ka bërë shkelje të Kushtetutës, duke iu bashkuar kështu shkeljeve të vazhdueshme që bën qeveria. Pasi nuk kanë arritur që në rrugë normale kushtetuese ta imponojnë agjendën e tyre politike në legjislacion, shumica parlamentare, në bashkëpunim me presidenten, kanë vendosur



të bëjnë një akt të paprecedentë të mashtrimit publik me tekstin e ligjit dhe shkeljes së Kushtetutës", ka thënë Gruda.

Gruda ka theksuar se përmes këtij ligji pushteti synonte që

administratën e shtetit ta vinte në shërbim të partisë. "Gjykata ka gjetur një varg vërejtjesh, veçanërisht ka rrëzuar atë që ishte quajtur nga qeveria 'kriteri i përshtatshmërisë për punësim',

duke deklaruar se ky kriter, kështu siç është, është jokushtetues dhe nuk mund të përfshihet në ligj. Në aktgjykim u ngarkua Kuvendi i Kosovës dhe presidentja e Kosovës, që ta dekretonin ligjin

dhe ta botonin në gazetën zyrtare pa këtë formulim. Pra, ligji të ishte i pastruar nga kriteri i përshtatshmërisë. Për habinë tonë, kur morëm ta lexojmë ligjin e publikuar në Gazetën Zyrtare, pamë se ka ndodhur diçka që nuk ka ndodhur asnjëherë në përvojën kushtetuese dhe parlamentare të Kosovës së pavarur. Ligji ishte dekretuar pa u adresuar kërkesa e Gjykatës Kushtetuese për heqjen e përshtatshmërisë. Pra,

përshtatshmëria ekziston edhe sot në Ligjin e dekretuar nga presidentja dhe është botuar në Gazetën Zyrtare, përkundër se Gjykata Kushtetuese e kishte rrëzuar atë", ka thënë ai.

Gruda ka thënë se pushteti aktual do të mbahet mend për shkeljet sistematike që ia ka bërë Kushtetutës së Republikës së Kosovës. "Një gjë është e sigurt, se ky pushtet, përveç keqqeverisjes së skajshme, izolimit ndërkombëtar, korrupsionit, do të mbahet mend më së shumti për shkeljet sistematike që ia ka bërë aktit më të lartë juridik të shtetit tonë - Kushtetutës", ka thënë Gruda.

Miratohet udhëzuesi për mbrojtjen e personave që raportojnë për interes publik

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka njoftuar se është aprovuar udhëzuesi për mbrojtjen e personave që raportojnë për interes publik, detyrimet e punëdhënësve për mbrojtjen e sinjalizuesve nga aktet e dëmshme dhe të drejtat e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore.

Haxhiu ka thënë se ky udhëzues jep udhëzime për krijimin dhe mbajtjen e një sistemi të brendshëm konfidencial dhe të sigurt të menaxhimit të sinjalizimit në institucione. "Marrë parasysh se mbrojtja e sinjalizuesve

është thelbësore për funksionimin efektiv të sistemeve të brendshme të menaxhimit të sinjalizimit, udhëzuesi jep udhëzime për krijimin dhe mbajtjen e një sistemi të brendshëm konfidencial dhe të sigurt të menaxhimit të sinjalizimit në institucione, ofron udhëzime për mbrojtjen e sinjalizuesve nga veprimet e dëmshme, duke përfshirë krijimin dhe mirëmbajtjen e një mekanizmi për t'iu përgjigjur ankesave për veprime të dëmshme dhe ofron udhëzime për gjykatat dhe gjyqësorin për shqyrtimin e rasteve që përfshijnë

sinjalizues ose persona të lidhur me sinjalizues", ka njoftuar Haxhiu.

E para e drejtësisë ka thënë se miratimi i këtij udhëzuesi plotëson edhe më tutje legjislacionin për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. "Miratimi i këtij udhëzuesi plotëson edhe më tutje legjislacionin për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, duke pasur në epiqendër interesin publik dhe respektimin e ligjshmërisë, si dhe me qëllim të konsolidimit të vlerave demokratike dhe mbrojtjen e interesit publik", ka thënë Haxhiu.




ATK-ja për tetë muaj shqiptoi 3.1 milionë euro gjoba ndaj bizneseve

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se nga fillimi i këtij viti deri më sot janë realizuar mbi 25 mijë kontrolle të bizneseve me qëllim të parandalimit të evazionit tatimor. Sipas ATK-së, nga këto kontrolle janë shqiptuar 3.1 milionë euro gjoba. “Për tetë muaj janë realizuar 25 407 aktivitete të bizneset, të cilat kanë rezultuar me 3.1 milionë euro gjoba, ndërsa janë kryer 166 aktivitete për shmangie tatimore, prej tyre janë hapur 19 raste nën dyshimin e shmangies


tatimore”, ka njoftuar ATK-ja. Më tutje, ATK-ja ka theksuar se këto kontrolle ndaj bizneseve janë nxitur me qëllim që të zbatohen dispozitat tatimore. “Këto aktivitete janë zhvilluar në linjë me objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Përbushjes 2022-2026, ku pavarësisht pjesës së kampanjave sensibilizuese, të të cilat është relevante rritja e edukimit tatimor dhe informimi profesional rreth obligimeve që kanë ndaj institucionit tatimor, ATK-ja është e shtyrë t’i zbatojë dispozitat ligjore për çdo

tatimpagues të cilët nuk u binden thirrjeve të vazhdueshme që u bëhen që t’i kryejnë me kohë dhe saktë detyrimet tatimore”, ka njoftuar ATK-ja. ATK-ja ka bërë me dije se ka përmirësuar kapacitetet për t’i monitoruar të ardhurat tatimore të bizneseve. “Kjo është bërë përmes investimeve në teknologji të reja me ndihmën edhe të partnerëve ndërkombëtarë dhe përdorimit të sistemeve të informacionit për t’i ndjekur transaksionet tatimore”, ka njoftuar ATK-ja.



Skënderi: Qeveria nuk është duke prodhuar politika efikase ekonomike

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Prodhimi i Brendshëm (PBB) i Kosovës ka shënuar rritje reale për 2.02 për qind në tremujorin e dytë të këtij viti dhe se rënia e eksporteve të mallrave ka shënuar rënie rreth 11 për qind. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), kjo është rritja më e vogël ekonomike nga fillimi i 2021-s, ndërsa më e larta ishte në tremujorin e dytë të këtij viti me 16.32 për qind. “PBB-ja në tremujorin e dytë 2023 shënon rritje reale për 2.02 për qind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak”, ka njoftuar ASK-ja. Për profesorin e ekonomisë, Nagip Skënderi, qeveria aktuale është duke u ushqyer me propagandë dhe se nuk është duke prodhuar politika efikase. “Kjo qeveri është duke u ushqyer me propagandë ekonomike, me disa të dhëna statistikore që nuk përkojnë me realitetin aktual ekonomik. Qeveria aktuale nuk është duke prodhuar politika efikase ekonomike, sidomos politika fiskale që janë të qëndrueshme, që e stimulojnë prodhimtarinë e hapin vende të reja të punës”, ka thënë Skënderi për “Telegrafin”. Ai ka theksuar se trendi i rënies ekonomike është duke vazhduar. “Nuk ka investime të cilat gjenerojnë në



dobishmërinë ekonomiko-sociale, por kemi tkurrje të tyre dhe mendoj se trendi i rënies ekonomike është duke vazhduar, edhe pse thuhet se kemi rritje reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto për 2 për qind”, ka thënë Skënderi, duke shtuar se vërehet se nuk ka bashkëpunim ndërmjet Qeverisë së Kosovës me sektorin privat. “Vërehet se nuk është një bashkëpunim i qeverisë me sektorin privat dhe

nuk ka politikë ekonomike që qeveria mund t’i kanalizonte në zhvillimin e biznesit, të cilat janë të orientuara në subvencione, ku dihet se këto të fundit janë lëshime sociale”, ka thënë ai. Më tutje, Skënderi ka kërkuar të ndryshohet struktura ekonomike, duke stimuluar prodhimin. “Duhet të ndryshohet fundamentalisht struktura ekonomike, të orientohemi në stimulimin e

prodhimit dhe më tepër të stimulohen eksportet”, ka thënë Skënderi. Profesi universitar ka thënë se fuqizimi i sektorit privat duhet bërë përmes politikave afatgjatë ekonomike e jo përmes subvencioneve. “Të gjenerohen vendet e punës, të fuqizohet sektori privat duke i ofruar përkrahje jo përmes subvencioneve, por përmes politikave ekonomike të cilat kanë një qëndrueshmëri

afatgjatë për vende të reja të punës”, ka thënë Skënderi. Pas të dhënave të ASK-së, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e kanë kritikuar qeverinë Kurti për këtë normë, siç e kanë quajtur ata, të ulët ekonomike. PDK-ja dhe LDK-ja thonë se kjo rritje e ulët ekonomike po e degradon çdo ditë e më tepër standardin e jetës së qytetarëve në vend.

Për herë të parë në histori, borxhi kombëtar i ShBA-së 33 trilionë dollarë

WASHINGTON, 19 SHTATOR - Borxhi kombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka arritur në 33 trilionë dollarë. Shpenzimet e qeverisë tashmë janë nën vëzhgim të rreptë. Sipas të dhënave të Departamentit të Thesarit, ky borxh, i cili mat atë që ShBA-ja u detyrohet kreditorëve, arriti në këtë nivel që nga pasdita e së hënës. Vetëm katër dekada më parë ky borxh ishte rreth 907 mil-

iardë dollarë. “Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë arritur një moment historik të ri për të cilin askush nuk do të jetë krenar. Borxhi ynë kombëtar sapo ka tejkaluar vlerën e 33 trilionë dollarëve. Borxhi i zotëruar nga publiku kohën e fundit ka tejkaluar vlerën e 26 trilionë dollarëve”, ka thënë presidentja e Komitetit për Buxhetin Federal, Maya MacGuineas. Ky nivel historik i borxhit vjen kur Kongresi po përpiqet të

shmangë një mbyllje të Qeverisë Federale në fund të shtatorit. Gjetjet e fundit nga Zyra e Buxhetit të Kongresit tregojnë se borxhi kombëtar pothuajse do të dyfishohet në madhësi gjatë tri dekadave të ardhshme. Në fund të vitit 2022 borxhi kombëtar u rrit rreth 97 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Sipas ligjit aktual, kjo shifër pritet të rritet në 181 për qind në fund të 2053-s.



Gjenerata Z: A e njihni?



Gjenerata Z i detyrohet për karakteristikat e veta, faktit që janë rritur në një botë dixhitale dhe të globalizuar, e cila u ka dhënë atyre një ndërgjegje sociale dhe një vëmendje ndaj teknologjisë. Zbuloni më shumë rreth tyre

A e njihni Gjeneratën Z? I referohet grupit demografik që pason gjeneratën ose gjeneratën e mijëvjeçarit ose Gjeneratën Y. Ato që në moshë të vogël kanë pasur kontakt me një botë dixhitale dhe të globalizuar, me akses në internet, pajisje celulare dhe rrjete sociale.

A e dini se aktualisht është brezi më i ri dhe se anëtarët e tij përfaqësojnë të ardhmen e shoqërisë sonë? Dhe kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të kuptojmë se çfarë e shtyn përpara këtë brez dhe çfarë qëndron përtej kritikave që i janë adresuar.

Karakteristikat e Gjeneratës Z

Edhe pse nuk ka një përkufizim të saktë dhe universal që përcakton kufijtë kohorë, në përgjithësi individët e lindur midis viteve 1997 dhe 2012 ose 2015 konsiderohen se i përkasin këtij brezi, që do të thotë se ata paraqesin karakteristika dalluese që ndikojnë në identitetin e tyre.

Lidhja me teknologjinë

Siç e kemi nënvizuar tashmë, një nga karakteristikat kryesore të

gjeneratës Z është lidhja e thellë me teknologjinë. Ata përdorin lehtësisht mjete dixhitale për komunikim, argëtim, kërkim informacioni ose ndonjë aktivitet tjetër.

Në një artikull të botuar nga revista dixhitale e-mentor, bëhet me dije se teknologjitë e reja përfaqësojnë mjedisin e tyre natyror, të shenjuar nga një progres marramendës dhe globalizim edhe më të madh. Si rezultat, ata konsiderohen si "dixhitale autoktonë", pasi kjo gjeneratë ka pësuar një ndryshim të rëndësishëm teknologjik në krahasim me gjeneratat e mëparshme.

Të përkushtuar ndaj diversitetit

Çfarë kuptojmë me këtë? Ata u rritën në një shoqëri gjithnjë e më gjithëpërfshirëse dhe multikulturore. Prandaj, ata vlerësojnë diversitetin për sa i përket racës, përkatësisë etnike, orientimit seksual dhe gjinisë. Në shumicën e rasteve ata u rritën në një mjedis që favorizon pranimin dhe të drejtat e barabarta për të gjithë.

Gjenerata Z dhe aktivizmi

Gjenerata Z ka treguar një interes të fortë për aktivizmin social dhe politik. Ata kanë promovuar lëvizje dhe protesta për çështje të tilla si ndryshimet klimatike, barazia gjinore, drejtësia racore dhe çështje të tjera të rëndësishme sociale.

Promovues të shëndetit mendor

Gjenerata Z ka përjetuar sfida psikologjike. Prandaj, shëndeti dhe mirëqenia mendore janë çështje të rëndësishme për ta. Pse? Ata kanë patur akses në informacione rreth çrregullimeve mendore, teknikave të menaxhimit të stresit dhe strategjive të kujdesit vetiak, përmes burimeve në internet, mediave sociale dhe programeve arsimore. Ky ndërgjegjësim i rritur i ka lejuar të identifikojnë dhe kuptojnë më mirë problemet e shëndetit mendor, si dhe rëndësinë e kujdesit.

Për më tepër, kanë promovuar një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën e trajtimit të problemit. Qëndrimet e tyre të hapura dhe të sqarta për përvojat kanë shërbyer për të nxitur biseda më të hapura rreth tyre. Duke eliminuar stigmën e çështjeve të shëndetit mendor dhe duke inkurajuar të tjerët që të kërkojnë mbështetje, ata kanë krijuar një mjedis më të sigurt dhe më kuptues për të diskutuar dhe trajtuar çështje të tilla. Ata kanë adoptuar një qëndrim proaktiv ndaj kujdesit vetiak mirëqenies emocionale. Ata pranojnë se adresimi i çështjeve psikologjike është thelbësor për mirëqenien e përgjithshme dhe cilësinë e jetës. Ndryshe nga gjeneratat e mëparshme, Z është fokusuar në parandalimin dhe mirëqenien afatgjatë, në vend që të presë që

problemet e shëndetit mendor të bëhen të pamenaxhueshme. Pa dyshim, teknologjia ka luajtur një rol vendimtar në këtë qasje.

Dallimi midis gjeneratës së mijëvjeçarit dhe gjeneratës Z

Ndërsa përkufizimet dhe datat e sakta që shënojnë tranzicionin midis brezave mund të ndryshojnë, ka dallime të përgjithshme midis "mijëvjeçarëve" dhe gjeneratës Z. Ja disa prej tyre:

Gama e datëlindjeve të "mijëvjeçarëve" është përgjithësisht midis fillimit të viteve 1980 dhe mesit të viteve 1990, ndërsa Gjenerata Z u referohet atyre që kanë lindur midis mesit të viteve 1990 dhe mesit të viteve 2000.

Mijëvjeçarët mund të kujtojnë një botë përpara mediave sociale dhe të kenë përjetuar kalimin në një shoqëri gjithnjë e më shumë online. Nga ana tjetër, Gjenerata Z është rritur në një botë ku ndërveprimi social në internet është normë dhe rrjetet sociale luajnë një rol qendror në jetën e tyre të përditshme.

Mijëvjeçarët janë përballur me një treg pune sfidues, me norma të larta papunësie dhe vështirësi për të hyrë në fuqinë punëtore që nga recesioni ekonomik i vitit 2008. Gjenerata Z gjithashtu përballet me sfida të ngjashme, por është më e fokusuar në sipërmarrjen dhe krijimin e aktiviteteve të veta që në moshë

të re. Është e rëndësishme të theksohet se këto dallime janë të përgjithshme dhe mund të ndryshojnë midis individëve brenda çdo brezi. Për më tepër, kufijtë midis brezave janë të paqartë dhe mund të mbivendosen, pasi karakteristikat dhe tendencat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

Një brez për të ardhmen

Ndryshe nga sa mendon shumëkush, një përmbledhje sistematike e botuar në Gazetën Evropiane të Trajnimit dhe Zhvillimit zbuloi se Gjenerata Z ka plane shumë të qarta zhvillimi, si dhe ka pritshmëri të përcaktuara profesionale. Prandaj duhet të besojmë në aftësitë e atyre që e përbëjnë atë dhe në të ardhmen që na pret me ta.

Nuk duhet të harrojmë se ata kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm, si për shembull për t'i dhënë shëndetit mendor rëndësinë që i takon apo duke luftuar për diversitetin. Duke u rritur në një botë gjithnjë e më komplekse dhe kërkuese, ata përjetuan vetë sfidat që lidhen me to dhe e kuptuan nevojën për t'i trajtuar.

Në fund, është e nevojshme të kuptohet se çdo epokë gjeneron individë të ndryshëm me karakteristika të caktuara. Kjo do të sjellë gjithmonë mënyra të reja të lidhjes dhe konceptimit të botës. / bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Ballkani vazhdon rrugëtimin historik në Ligën e Konferencës

SUHAREKË, 19 SHTATOR - Ballkani do ta zhvillojë ndeshjen e parë kundër Viktoria Plzenit në fazën e grupeve në Ligën e Konferencës, më 21 shtator (të enjten), me fillim nga ora 21:00. Kjo paraqitje e ekipit

suharekas në nivelin e tretë të garave evropiane për skuadra të futbollit, është sukses historik të cilin Ballkani e realizoi dy herë radhazi. Pas ndeshjes së fundit të Ballkanit në Superligën e Kosovës, pas barazimit me

Dukagjinin 1:1, ekipi do ta vazhdojë ndeshjen e radhës mysafir te Viktoria Plzeni. Ballkani ndeshjet evropiane si vendës do t'i luajë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Më 5 tetor pret Dinamo Zagrebin e më 26

tetor Astanën, ndërsa udhëton në Kazakistan më 9 nëntor. Kampioni aktual i Kosovës më 30 nëntor luan në shtëpi ndaj Plzenit, kurse e mbyll fazën e grupeve si mysafir i Dinamo Zagrebit më 14 dhjetor.



Vëmendja në përballjen Bayern - United

"Epoka e re"

MUNCHEN, 19 SHTATOR - Tetë ndeshjet e tjera në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve zhvillohen sonte (e mërkurë). Padyshim se përballja kryesore është mes Bayern Munchenit dhe Manchester Unitedit. Bayern Munchen hyn në këtë ndeshje me një bilanc të mirë. Në pesë ndeshjet si vendas ka regjistruar tri fitore dhe dy barazime, ndërsa kampionët gjermanë janë të bindur se do ta kalojnë me sukses fazën e grupeve ku bëjnë pjesë edhe Galatasaray dhe FC Copenhagen. Bayern Munchen e nisi mirë sezonin e ri në

Bundesliga duke fituar tri ndeshjet e para, por në ndeshjen e katërt luajti baras të premtën me Bayer Leverkusenin (2-2). Në anën tjetër trajneri i Manchester Unitedit, Erik ten Hag, shpresonte që me një rezultat pozitiv ndaj klubit gjerman ta rikthejnë atmosferën në "Old Trafford", pas një jave aspak pozitive ku pësoi humbje me rezultat 3-1 në shtëpi ndaj Brighton & Hove Albion. I pozicionuar aktualisht në vendin e trembëdhjetë në Premierë Ligë dhe mbetjes prapa nga skuadrat e tjera konkurrense, Unitedi beson se mund t'u rikthehet rezultateve pozitive dhe të këtë sezon të suksesshëm. Për këtë ndeshje shumë të



rëndësishëm mesfushori i Bayern Munichut, Joshua Kimmich, është në dyshim se mund të paraqitet, kurse mungojnë Manuel Neuer, Kingsley Coman, Raphael Guerreiro dhe Tarek Buchmann. Në anën tjetër

Unitedi pritet të jetë pa Aaron Wan-Bissaka, Raphael Varane, Luke Shaw, Tyrell Malacia, Mason Mount, Sofyan Amrabat, Tom Heaton, Amad Diall, Kobbie Mainoo si dhe dyshja e rrezikshme Sancho-Antony.

Të mërkurën takohen:

- 18:45 Galatasaray - FC Copenhagen
- 21:00 Bayern Munchen - Manchester United
- 21:00 Arsenal - PSV Eindhoven
- 21:00 Sevilla - Lens
- 18:45 Real Madrid - Union Berlin
- 21:00 SC Braga - Napoli
- 21:00 Benfica - FC Salzburg
- 21:00 Real Sociedad - Inter

Sonte luan edhe nënkampioni në fuqi i kësaj gare, Interi. Klubi italian që shkëlqeu në fundjavë ndaj Milanit do të jetë mysafir i skuadrës spanjolle Real Sociedad, ndërsa Real Madridi e pret skuadrën gjermane Union Berlin.

KOK-u dhe MKRS-ja nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për Lojërat Mesdhetare

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për organizimin e Lojërave Mesdhetare që do të zhvillohen në Kosovë në vitin 2030. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, deklaroi se kjo është një ngjarje historike për Kosovën sepse, bazuar në hapësirën territoriale që ka Kosova, ato kanë rëndësinë e njëjtë me Lojërat Olimpike që organizohen vitin e ardhshëm në Francë. Ai ka shtuar se 19 komuna në Kosovë do të shndërrohen në qendra të mëdha sportive dhe se ato do të jenë përfituese të investimeve në infrastrukturën sportive, ku do të përfshihet ndërtimi dhe renovimi i 24 objekteve sportive, edhe ndërtimi i stadiumit kombëtar. "Koncepti me të cilin kemi fituar aktualisht ka dy shtete dhe 11 komuna të cilat do të shndërrohen në qendra të këtij organizimi, duke përfshirë 10 komuna në Kosovë dhe Durrësin në



Shqipëri. Janë 24 objekte sportive, prej të cilave dhjetë do të rinovohen, përfshirë sallën e djegur të Pallatit të Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë, katër të reja do të ndërtohen, përfshirë stadiumin nacional dhe kompleksin e pishinave olimpike, pesë të tjera të cilat janë në ndërtim e sipër, përfshirë stadiumin e Gjilanit dhe atë të Mitrovicës, pesë investime të përkohshme që do t'u shërbejnë sportistëve në disiplina të ndryshë, si 3x3 basketboll, lundrimi, çiklizmi dhe të tjera", ka thënë Çeku, raporton

KP. I pari i MKRS-së përsëriti se kostoja totale e investimeve në infrastrukturë do të arrijë vlerën prej 250 milionë eurosh, derisa bëri me dije se në Kuvendin e Kosovës do të hartohet një ligj i veçantë për organizimin e kësaj ngjarje sportive. Nga ana tjetër, presidenti i Komitetit Olimpik i Kosovës, Ismet Krasniqi, ka deklaruar se marrja e të drejtës së organizimit të Lojërave Mesdhetare ishte një premtim i dhënë nga udhëheqja e re e KOK-ut, por deri te

ky rezultat kishte sfida të mëdha, sidomos për shkak të lobimit të madh nga Serbia kundër Kosovës në këtë proces dhe se për 55 votat për të marrë në Asambleenë e Përgjithshme të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare, u desh të bëhej fushatë e jashtëzakonshme nga ana e gjithë shteti i Kosovës. "Marrja e organizimit të një ngjarje kaq madhore siç janë Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030' ka qenë premtim dhe synim imi dhe i bordit të tanishëm të Komitetit Olimpik të Kosovës që nga ardhja jonë në udhëheqje të lëvizjes olimpike... Ka një vit që jemi përballur me sfida të ndryshme për ta përjetuar së bashku këtë moment historik. Sfida më e madhe ishte mungesa e daljes në det e cila na penalizoi dhe na detyroi ta ndryshojmë statutin e ICMG-së... Sfidë e madhe dhe e pritshme ishte edhe ofensiva e madhe e Serbisë e cila me të gjitha forcat tentonte ta parandalonte kandidaturën tonë", ka deklaruar Krasniqi. E ngazëllyer që Kosova e ka fituar të

drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare u shpreh edhe kampionia olimpike, Majlinda Kelmendi. Ajo para të pranishmëve kërkoi të punohet që t'i tregojmë botës vlerat e Kosovës. "Jam jashtëzakonisht e lumtur që sukseset e mëdha të sportistëve tanë po përcillen edhe me organizime serioze në vendin tonë siç janë Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030'. Unë po apeloj që t'i lëmë fjalët, t'i përvishemi punës që t'i tregojmë botës çfarë vlera kemi ne jo vetëm si sport, por edhe si komb. T'i mirëpresim njerëzit, qytetarët, sportistët ashtu siç dimë ne sepse ne shqiptarët mikpritjen e kemi virtyt, kështu që të punojmë në maksimum e të mos flasim shumë", ka deklaruar Kelmendi. Kosova fitoi të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare me 55 vota për dhe tetë kundër në Asambleenë e Përgjithshme të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare të mbajtur më 8 shtator në Heraklon të Greqisë.

Rrahmani i gatshëm për ndeshjen ndaj Bragës

NAPOLI, 19 SHTATOR - Kampioni i Italisë, Napoli, të mërkurën e fillon aventurën në Ligën e Kampionëve. Në "Estadio Municipal de Braga" do të përballlet me vendasit e

Bragas, një përballje që pritet të jetë spektakolare. Një ditë përpara kësaj sfide ka ardhur edhe një lajm i mirë për teknikun Rudi Garcia, i cili, për dallim nga sfida e fundjavës, ku arriti

të siguronte barazimin 2-2 ndaj Genoas, kësaj radhe në fushën e blertë do të ketë kapitenin e "dardanëve" të Kosovës, Amir Rrahmanin. Ky i fundit nuk ishte në skuadër

në sfidën e së shtunës dhe mungesa e tij shkaktoi probleme në mbrojtjen e "bluve", të cilët pësuan dy gola nga një ekip i sapoinkuadruar në elitën e Italisë nga Seria B.



Mundësi Abakarov siguron biletën për në 'Paris 2024'

TIRANË, 19 SHTATOR - Mundësi Zelimkhan Abakarov bëhet sportisti i dytë shqiptar që siguron kualifikimin për në Lojërat Olimpikë "Paris 2024" që zhvillohen pas një viti në

Francë. Lajmin e konfirmoi Federata Shqiptare e Mundjes. Medalja e bronzit që Abakarov fitoi një ditë më parë në Botërorin e Beogradit (Serbi), ku u klasifikua i treti, ka

kualifikuar direkt mundësin me origjinë ruse, por me pasaportë shqiptare për në Olimpiadë. Abakarov do të garojë në peshën 57kg, ku dhe fitoi të bronzit në një vit më parë u

shpall kampion bote. Në Olimpiadë ka siguruar një biletë edhe atletja Luiza Gega, që ka siguruar normën e kualifikimit në garën 3 000 metra me pengesa.



Mezani: Ende nuk e di se çfarë më shkruan në kontratë, erdha për 'Skifterat'

GJILAN, 19 SHTATOR - Trajneri Gentjan Mezani u rikthye te SC Gjilani në një moment jo aq të favorshëm që po kalon klubi, por ai zbulon arsyen pse e bëri këtë gjë. "Timonieri" vlonjat kishte kaluar më parë dy vjet bashkë me klubin gjilanas, që e konsideron të mrekullueshëm dhe një nga arsyet pse u kthye.

Pas largimit të Zekerija Ramadanit drejt Arabisë Saudite dhe dorëzimit të presidentit Florim Zuka -Tali, klubi u fut në një tunel. Por pas disa muajsh punë dhe angazhim, klubi ka një kryesi të re, ndërsa timonin e skuadrës e ka marrë një emër i njohur dhe i dashur për ambientin bardhë e kuq. Bëhet fjalë për Gentjan Mezanin, me të cilin klubi ka pasur suksese të mëdha, por fillimisht në sezonin 2018/2019, kur ai erdhi në mars, Gjilani ishte duke luftuar për të mbetur në elitë, që e arriti me vlonjatin në barazh, duke e rrëzuar Besën e Pejës me fitoren 1-0. Mezani kur u prezantua për herë të parë te Gjilani, krijoi një skuadër të fortë, duke luftuar deri në xhiron e fundit për titull kampioni, të cilën e humbi nga Drita, edhe pse kishin pikë të barabarta në fund, nga 66 sosh. Gjilani e humbi titullin në atë kohë, por i siguroi garat ndërkombëtare për herë të parë në histori të klubit. Madje në atë vit kaloi edhe një raund, duke eliminuar Tre Penne me rezultat 3-1, ndërsa në raundin e dytë luajti kundër Apoel Nicosia dhe humbi vetëm në kohën shtesë në "Fadil Vokrri". Këto suksese dhe loja e sigurt e Gjilanit nën drejtimin e Mezanit, kishin mbetur në zemrën dhe mendjen e "Skifterave", por edhe te trajneri vlonjat. Mezani në një intervistë për "Telegrafin" ka folur për aventurën e dytë në Gjilan, fitoren



e parë që erdhi pas katër ndeshjesh dhe gjithçka tjetër.

Keni arritur fitoren e parë në këtë sezon. Sa është e rëndësishme për Gjilani kjo?

Mezani: Çdo fitore është e rëndësishme, por kur vjen edhe pas disa vështirësive që i dini tashmë, mendoj se të jep më shumë forcë për të shikuar përpara pozitivisht.

Ka pasur shumë ndryshime për të mos thënë të tërësishme nga Gjilani i sezonit të shkuar. Sa jeni të kënaqur me fondin e lojtarëve dhe punën e tyre?

Mezani: Mendoj se kemi afruar futbollistë shumë të mirë edhe pse kemi pasur disi vështirësi, sepse normalisht që kemi filluar shumë vonë dhe zgjedhjet kanë qenë të pakta. Por, siç theksova, jam shumë i kënaqur me lojtarët të cilët kanë ardhur në merkato.

Dihet që keni filluar vonë organizimin dhe stërvitjet. Deri ku mund të arrini me këta lojtarë, cili është synimi në sezonin vjeshtor?

Mezani: Ky është një grup që të lejon të punosh mirë, pasi janë pothuajse të gjithë lojtarë të rinj dhe kanë dëshirë të madhe për t'u

përmirësuar. Do të mundohemi të marrim ndeshjet një e nga një dhe më pas do të shikojmë se ku do të arrijmë.

Keni gjetur lojtarë të rinj në Gjilan si Arjon Bllaca, Redon Ismaili, Oltion Billali e të tjerë... Si ju duken dhe çfarë pret në të ardhmen nga ta?

Mezani: Janë lojtarë me cilësi shumë të mira, por kryesorja është ajo të cilën e theksova pak më parë, dëshira që ata kanë për t'u përmirësuar nga dita në ditë.

Çfarë premton Gjilani i këtij edicioni?

Mezani: S'më pëlqen të jap premtime, por një gjë do të jetë e sigurt, që çdo ndeshje do të jetë sikurse një finale për ne.

Aventura e dytë te Gjilani, sa jeni menduar dhe si e pranuat ofertën?

